



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .06.2024

**MBLEDHJA Nr. 19,
Datë 10.06.2024, ora 11:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e hënë, datë 10.06.2024, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 19 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin maj 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022.
3. Mbi licencimin e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
4. Mbi licencimin e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “FU-GEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “MALIDO - ENERGJI” sh.p.k. dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
9. Mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të asetëve fikse të saj.

10. Mbi kërkesën e shoqërisë “SMART TRADE & CONSULTING” sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

11. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 41, datë 10.03.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “AGE KUÇ” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kuç” me kapacitet të instaluar 1930 kW”, i ndryshuar.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARI I BORDIT
Maksim SHULI